



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT  
(Auditim Tematik)**

**“Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”  
në Ministrinë e Drejtësisë**

**MAJ 2024**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm	4
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>5</b>
1.	Objekti i auditimit	5
2.	Qëllimi i auditimit	5
3.	Identifikimi i çështjes	5
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5
5.	Përgjegjësitë e Audituesve	5
6.	Kriteret e vlerësimit	6
7.	Standardet e auditimit	6
8.	Metodat e auditimit	6-7
9.	Dokumentimi i auditimit	7
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>7-8</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7-8
2.	Rezultatet e auditimit sipas objektit të auditimit	9-10
2.1	Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale	10-22
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>22-25</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>25-27</b>

**I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE****1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit Nr.1067 Prot , datë 05.12.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 06.12.2023 deri në datën 29.01.2024 në Ministrinë e Drejtësisë u krye auditimi i përputhshmërisë sipas një drejtimi të veçantë (tematik) në lidhje me vlerësimin e rregullshmërisë për zbatimin e kontratës Nr.8383/10 Prot, datë 21.02.2017 me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” (ku afati i fillimit të shërbim-furnizimit ishte data 21.02.2017 dhe afati i përfundimit të kontratës më datën 21.03.2021). Objektivi i auditimit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale në institucion. Për të arritur objektivin e auditimit, nga grupi i auditimit janë kryer teste auditimi mbi zbatimin e kontratës “Për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” ku kanë rezultuar efekte negative në menaxhimin e fondeve buxhetore trajtuar në materialet e auditimit.

**2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

Në përfundim, kanë rezultuar efekte negative në menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve buxhetore të shpenzuara në kuadër të kësaj kontrate dhe nuk është arritur përmbushja e qëllimit të përmirësimit të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale për të cilën janë dhënë rekomandimet e mëposhtme:

**1.** Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) të marrin masa dhe analizojnë me përgjegjësi të gjithë parregullsitë e rezultuara gjatë procesit të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të mbikëqyrjes elektronike të personave.

**2.** Ministria e Drejtësisë të ngrejë një grup pune dhe marrë masat dhe verifikimin e ekzistencës dhe saktësimin vlerës së aktiveve afatgjata materiale dhe atyre qarkulluese, të kontabilizuara dhe paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara të institucionit.

**3.** Ministria e Drejtësisë në procedurat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në prokurimin publik. Në përbërje të grupeve të punës për procesin e mbikëqyrjes elektronike të angazhohen specialistë të IT-së për të mundësuar zgjidhjen e problemeve në kohë reale.

**4.** Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrin masa të menjëhershme të përcaktimit të mjeteve dhe mekanizmave që mundësojnë bërjen efektive, funksionimin dhe sjelljen në eficencë të plotë të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, ku shërbimi të ofrojë garancinë e sigurisë publike dhe ekzekutimin efektiv të vendimmarrjeve gjyqësore, në zbatim të Ligjit 10 494 datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” dhe të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.



### 3. Konkluzioni i përgjithshëm

Objektivi i auditimit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale në institucion. Në përfundim të auditimit, u arrit në **konkluzionin**:

Janë konstatuar parregullsi e shkelje në zbatimin e kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, në fazën e zbatimit dhe monitorimit të Kontratës së Prokurimit të Shërbimit me Nr.8383/10 Prot, datë 21.02.2017, të lidhur midis autoritetit kontraktor Ministria e Drejtësisë dhe BOE “S.S“ sh.p.k, “F.” sh.p.k dhe “R.” sh.p.k, me objekt “*Përmirësimi i sistemit te mbikëqyrjes elektronike në fushën penale*” të cilat kanë rezultuar me efekte negative në menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve buxhetore të shpenzuara në kuadër të kësaj kontrate duke mos arritur përmbushjen e qëllimit, përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale.

- Ky sistem nuk është efektiv dhe i aplikueshëm nga organet e sistemit të drejtësisë, informacioni nga MD me shkresat Nr. 4716/15 Prot, datë 10.08.2017 dhe Nr. 4716/16 Prot, datë 11.08.2017 drejtuar Organeve të Sistemit të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për mos aplikimin e dënimit alternativ mbikëqyrje elektronike e personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor, mekanizëm që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

- Ndërprerja e kontratës së Mbikëqyrjes Elektronike, referuar shkresës Nr.6473 Prot, datë 19.09.2019, ka bërë të pa zbatueshëm Ligjin Nr. 10494, date 22.12.2011 "*Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*".



## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit për kryerjen e auditimit tematik Nr.1067 Prot , datë 05.12.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 06.12.2023 deri në datë 29.01.2024 në subjektin Ministria e Drejtësisë u krye auditimi tematik “Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” nga:

### Grupi i Auditimit me përbërje:

1. N. M, Përgjegjës Grupi
2. A. K, Audituese
3. R. K, Auditues
4. L. L, Audituese

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**1. Objekti i këtij auditimi** është auditimi i ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në lidhje me zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale.

**2.Qëllimi i auditimit** është dhënia e një konkluzioni mbi objektin e auditimit si dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj. Çështja të cilat do të trajtohen në këtë raport, lidhet me auditimin “Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale.”

### 3. Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi i ligjshmërisë për zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, parashikuar sipas drejtimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në autorizimin për kryerjen e auditimit tematik Nr.1067 Prot, datë 05.12.2023, i ndryshuar me Nr.1067/1 Prot, datë 05.01.2024.

### 4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse e linjës dhe institucionet përkatëse të varësisë shqyrtojnë përputhshmërinë me politikën, strategjitë e legjislacionin sektorial dhe kushtet teknike të veçanta për objektin përkatës. Stafit menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### 5.Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla



kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

#### **6. Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
- Ligji Nr. 10494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”;
- Ligji Nr.78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”;
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligj Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”
- VKM Nr.302, datë 25.3.2009 “Për miratimin e rregullores për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”;
- VKM Nr. 377, datë 06.06.2012 "Për kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe të drejtat e detyrimit e tij”;
- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar;
- VKM Nr. 703, datë 29.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.2, date 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. 5745, datë 13.08.2008 për miratimin e Rregullores së brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

#### **7. Standardet e auditimit:**

Auditimi u bazua në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- INTOSAI-P 1 “Deklarata e Limës për udhëzimet e Auditimit”
- INTOSAI-P 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t”,
- INTOSAI-P 30“ Kodi Etikës”.
- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”

#### **8. Metodatat e auditimit:**

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:



(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-*Vendimet e Kolegjit Administrativ e Penal të GJL dhe vendimin e GJKKO, etj.;*

7-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### **9. Dokumentimi i auditimit:**

Gjatë ushtrimit të auditimit tematik, objektivi i auditimit është përqendrimi i auditimit në çështje, problematika, tematika, apo sektorë specifikë, aktiviteti i subjektit të audituar është në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse. Vlerësimi i riskut, në auditimet tematike (përputhshmërisë), është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieeve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Projekt Raporti i Auditimit, i dërguar me anë të shkresës me Nr.1067/10 Prot, datë 28.03.2024, në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe sipas dakordësimit të paraqitur nga subjekti me shkresën Nr.769/8 Prot, datë 08.05.2024, protokolluar në KLSH me Nr.1067/11 datë 09.05.2024, u përgatit Raporti i Përfundimtar i Auditimit.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

*Ministria e Drejtësisë*, në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjet, ushtron funksionet dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale e civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së



Shqipërisë. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë. Ligji Nr. 10494, datë 22.12.2011 "*Për mbikëqyrjen elektronike te personave, te cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*", ka përcaktuar në nenin 20 të tij se, menjëherë pas hyrjes në fuqi, fillon të zbatohet ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i këtij ligji, gjykimi i të cilave është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, të cilat urdhërojnë përdorimin e ME-së, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësinë teknike të realizimit të saj. Zbatimi i ligjit ndaj personave të parashikuar nga neni 4 i këtij ligji, që nuk janë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, fillon sipas afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të fondeve financiare të vëna në dispozicion për realizimin e mbikëqyrjes elektronike. Ndërsa në Nenin 21 të tij ligji ka përcaktuar se, ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 11, pika 3 dhe të nenit 20, pika 2 të këtij ligji. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 12, pika 4 dhe të nenit 18, pika 6 të këtij ligji.

Në referim të VKM Nr. 377, datë 06.06.2012 "*Për kriteret që duhet të plotësoje organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe te drejtat e detyrimit e tij*" organi shtetëror që realizon mbikëqyrjen elektronike, në fazën e projektit pilot, është Shërbimi i Provës, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, si organ epror i Shërbimit të Provës, ka detyrimet e mëposhtme: a) t'i sigurojë Shërbimit të Provës mjedise të mjaftueshme për realizimin e mbikëqyrjes elektronike b) të sigurojë personelin e nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes elektronike c) të marrë të gjitha masat për të siguruar trajnimin e personelit shtetëror të përfshirë në mbikëqyrjen elektronike ç) të sigurojë postet e punës për kompjuterët e përdoruesve fundorë (*client computers*) për sistemin e mbikëqyrjes elektronike; d) të sigurojë shpejtësi të mjaftueshme të aksesit në internet të kompjuterëve fundorë për komunikimin nëpërmjet internetit (*via web*) me sallën operative.

*Shërbimi i Provës* është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe i centralizuar, i organizuar në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës (*këtu e më poshtë DPSHP*) dhe në nivel vendor nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Misioni i Shërbimit të Provës është promovimi i përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përbëhet nga tre drejtori: Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare, Drejtoria e Mbikëqyrjes Elektronike dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Mbikëqyrja Elektronike është një nga reformat e realizuara në sistemin e drejtësisë penale shqiptare dhe ka filluar funksionimin në Mars të vitit 2013. Mbikëqyrja elektronike përdoret për personat të cilët janë subjekt i:

- ✓ Masave shtrënguese (Kodi Procedurës Penale, pikat a, c dhe d)
- ✓ Dënimeve alternative (Kodi Penal, neni 58, 59, 59/a dhe 64)
- ✓ Dënimeve plotësuese (Kodi Penal, paragrafi 7 i nenit 30)
- ✓ Urdhrave të mbrojtjes ose urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes (Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 "*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*", te ndryshuar., neni 17 dhe 19)





Kufizimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, mbikëqyren nëpërmjet pajisjes e cila vendoset në trupin e personit nëpërmjet sallës operative ngritur për këtë qëllim. Pajisja i komunikon sallës operative daljen nga zona e lejuar apo hyrjen në zonën e ndaluar. Gjykata ose Prokuroria kërkojnë zbatimin e mbikëqyrjes elektronike për persona të mitur apo të rritur të cilët paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe personat të cilët akuzohen për një veprë penale që dënohet jo me shumë se me 5 vjet burgim. Personi duhet të japë pëlqimin për tu vënë në mbikëqyrje elektronike përveçse në rastet kur parashikohet në ligj. Aktorët e rëndësishëm të këtij procesi janë Gjykatat, Prokuroritë, Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Provës. Mbikëqyrja elektronike funksionon nëpërmjet një byzylyku elektronik i cili vendoset mbi kyçin e këmbës së personit dhe mbahet nga personi në çdo moment. Ai ka peshe të lehtë, është rezistent ndaj goditjeve dhe ujit gjë që bën të mundur vazhdimin e aktiviteteve normale të përditshme pa u penguar nga pajisja.

#### **2. Rezultatet e auditimit sipas objektit të auditimit**

Në zbatim të Autorizimit për kryerjen e auditimit tematik Nr.1067 Prot, datë 05.12.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH, i ndryshuar, *u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:*

- Kontratë Prokurimi Shërbimi Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 “*Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale*”;
- Urdhri Nr. 8383/12 Prot, datë 23.02.2017, për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ;
- Dokumentet Standarde të Procedurës së Hapur Shërbime “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”;
- Shtojcë për një saktësim në Dokumentet e Tenderit, Tiranë më 11.01.2017;
- Shtojcë në Dokumentet e Tenderit, Tiranë më 31.01.2017;
- Formular i Sigurimit të Kontratës Nr. Serie 0020161 datë 21.02.2017 i lidhur me Shoqërinë e Sigurimeve “E.” në vlerën 23.395.200 lekë;
- Faturë Tatimore Shitje Nr.31, datë 21.03.2017 me numër serie 33183442 të Operatorit ekonomik “R.” vlefte me TVSH 221.952.000 lekë;
- Proces Verbal marrje në dorëzim datë 21.03.2017 për Byzylyk Elektronikë;
- Fletë Hyrje Nr.19 datë 21.3.2017 vlefte me TVSH 30.060.000 lekë;
- Proces Verbal marrje në dorëzim datë 21.03.2017 për Sistem Akses Kontroll;
- Fletë Hyrje Nr.19/1 datë 21.3.2017 vlefte me TVSH 3.000.000 lekë;
- Proces Verbal marrje në dorëzim datë 21.03.2017 për Sistem Kamera Sigurie;
- Fletë Hyrje Nr.19/2 datë 21.3.2017 vlefte me TVSH 1.176.000 lekë;
- Dokument Trajnimi për Stafin me 12 punonjës datë 20.03.2017;
- Akt Dorëzimi nga BOE “R.” për tre mallra, 300 copë Byzylyk Elektronikë (+ Sim Card) IMEI bashkangjitur, një Sistem Akses Kontroll, dhjetë Sistem Kamera Sigurie datë 21.03.2017;
- Fletë Dalje Nr.39 datë 21.03.2017 e 300 copë Byzylyk Elektronikë;
- MEMO informuese Nr.8383/15, datë 28.03.2017 drejtuar Sekretares së Përgjithshme mbi realizimin e shërbimeve dhe marrjen në dorëzim;
- Relacion Teknik, Ministria e Drejtësisë “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” nga BOE “R.” (pa datë);
- Fletë Dalje e 300 copë byzylykë elektronike me Nr.834 Prot datë 06.04.2017;
- Urdhri Nr.4716/2 datë 31.07.2017 ish Ministri Teknik z. G. B për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar sipas kontratës me Nr.8383/10, datë 21.02.2017 me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”
- Procesverbali Nr.1 i datës 31.07.2017.



- Procesverbali Nr.2 i datës 31.07.2017;
- Procesverbali Nr.3 i datës 03.08.2017;
- Procesverbali Nr.4 i datës 09.08.2017;
- Procesverbali Nr.5 i datës 10.08.2017;
- Procesverbali Nr.6 i datës 11.08.2017;
- Procesverbali Nr.7 i datës 11-14.08.2017;
- Procesverbali Nr.8 i datës 18.08.2017;
- MEMO Nr.4716/19 Prot, datë 14.08.2017 nga Audituesit në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Shkresa Nr.2386 Prot, datë 21.05.2018 mbi propozimin për përmirësimin e specifikimeve teknike në sistemin e Mbikëqyrjes Elektronike drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë nga z. E.H, Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare;
- Raporti Inspektimit Financiar, MFE (Dhjetor 2018);
- Urdhri i Ministrisë të MFE, Nr. 329 datë 05.12.2018 me Nr.18415/25 Prot “Për përfundimin e Inspektimit Financiar Publik”;
- Shkresë e Sekretarit të Përgjithshëm Nr.6473 Prot, datë 19.09.2019 mbi ndërprerjen e kontratës;
- Depozitim Kundër Padie Nr.4065/8 Prot, datë 24.09.2019;
- Rekurs Nr.2209 Prot, datë 05.04.2023;
- Ankim datë 08.08.2017 Nr.3817/20 Prot, Kundër Vendimit për mos fillimin dhe procedimin e kallëzimit penal Nr.8078 viti 2017;
- Vendim Nr.30-2017-6627 Gjykata Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm datë 14.12.2017;
- Vendim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.264 datë 31.10.2017;
- Vendim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë Nr.224 datë 06.10.2020;
- Vendim Gjykata Administrative Apelit Tiranë Nr.64 datë 01.02.2023.

#### **2.1 Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale**

*Në lidhje me Kontratën e Prokurimit Shërbimit Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 dhe zbatimin e kontratës:*

Më datë 21.02.2017 është lidhur kontrata e prokurimit shërbimit me Nr.8383/10, Prot midis autoritetit kontraktor (AK) Ministria e Drejtësisë përfaqësuar nga ish Sekretari i Përgjithshëm znj. J.H dhe BOE “S.S” sh.p.k me Nipt L....F me Administrator znj. A. K, “F.” sh.p.k me Nipt J.....U me Administrator z. A. P, dhe “R.” sh.p.k me Nipt L....S me Administrator z. M. K, me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” me vlerë të kontraktuar 233.952.000 lekë (me TVSH) dhe afat zbatimi 4 vjet e 1 muaj nga data e nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të saj. Afati i fillimit të shërbim-furnizimit është data 21.02.2017 dhe afati i përfundimit të kontratës ka qenë data 21.03.2021. Objekti i kësaj kontrate është “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” në përputhje me Termat e Referencës Nr. Ref 64909 datë 12-29-2016, specifikimet teknike të projektit, grafikun e ekzekutimit të shërbimit dhe ofertën ekonomike të BOE “S.S” sh.p.k, “F.” sh.p.k, dhe “R.” sh.p.k.

#### **Konstatimi:**

Rezulton dhe se kjo kontratë ka shtim pikash në Nenet e KPK (Kushtet e Përgjithshme të Kontratës) dhe në Nenet në KVK (Kushtet e Veçanta të Kontratës), ku konstatohet se disa nene janë lënë bosh të paplotësuara si dhe ka shtim neni (Neni 11) krahasuar me Shtojcën 16 tek Dokumentet Standarde të Tenderit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Në lidhje me Nenet në KVK (Kushtet e Veçanta të Kontratës) konstatohet se disa nene janë lënë bosh të paplotësuara si dhe ka shtim Neni dhe pikash më konkretisht:

Në Nenin 2, Sigurimi i Kontratës është lënë bosh (i paplotësuar): Sigurimi i Kontratës do ti lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:\_\_\_\_\_

Neni 5, Informacioni që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor është lënë bosh (i paplotësuar) : Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet ti japë Kontraktuesit informacionin dhe dokumentet e mëposhtëm:\_\_\_\_\_

Neni 6, Kërkesat për Raportim është lënë bosh (i paplotësuar) :

Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:\_\_\_\_\_

Neni 7 Siguricioni i Përgjegjësisë Profesionale është lënë bosh (i paplotësuar) :

Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon:\_\_\_\_\_

Është shtuar tërësisht një Nen, Neni 11 Vendosja e pajisjes (byzylyk) dhe katër pika nenesh 11.1-11.4.

Kontrata Prokurimit Shërbimit Nr.8383/10 Prot, datë 21.02.2017 për sa përshkruar më sipër konstatohet se ka parregullsi në bazë të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” sipas Nenit 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1: “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, por dhe në referim të VKM Nr.914. datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 22 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës”.

#### **Konstatimi:**

Sa i përket KPK të Kontratës është shkelur Neni 6, pika 2 i cili lidhet me pronësinë intelektuale dhe dorëzimin në fund të kontratës nga BOE tek AK i kodit në burim, raporteve dhe hartave, diagrameve skicimeve dhe çdo materiali tjetër të mbledhur ose përgatitura nga kontraktuesi gjatë implementimit të kontratës. Pas kërkesa të përsëritura në mënyrë zyrtare pranë subjektit të audituar, grupit të audituesve të autorizuar të KLSH-së nuk i janë vënë në dispozicion sipas Shtojcës 12 “Termat e Referencës: Kodi në Burim, Testimi i Sistemit të Përmirësuar (rezultat i cili duhet të arrihet nga BOE), sipas pikës 2.3, Tre raportet, Sipas pikës 4.2 Detyrat Specifike 9. Testimi i Sistemit SME, 11.Go Live i Sistemit SME, 12. Mirëmbajtja e sistemit SME (për të cilën BOE “R.” nuk ka lëshuar faturë tatimore në asnjë moment, Raporti Fillestar, Draft Raporti, Raporti Final sipas pikës 6 Raportimi. Sipas Nenit 8, *Kontraktuesi duhet të kryejë gjitha shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës*, gjë që nuk ka ndodhur pasi në pikën 2.3 parashikohet Testimi i SME dhe Mirëmbajtja për një afat 4 vjeçar që nga momenti i implementimit të sistemit, shërbime të cilat nuk janë kryer pasi në asnjë moment përgjatë viteve nuk është lëshuar asnjë faturë nga BOE “R.”. Sipas Nenit 9 Nuk ka specifikime dhe Skicime. Lidhur me Nenin 19, që konsiston në vonesën në zbatimin e kontratës rezulton se afatet e vendosura në grafikun e ekzekutimit janë shkelur dhe tejkaluar me vonesë duke krijuar dëme për AK në kuadër të implementimit të kontratës. Sa i përket KVK Nenit 2, sigurimi i kontratës është i pa protokolluar dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normat Teknike Profesionale (nenet 11-20 dhe 25-31). Referuar Nenit 3 të KVK fillimi i kontratës është data e nënshkrimit të saj, e cila rezulton të jetë 21.02.2017 dhe në harkun kohor prej 30 ditësh nga kjo datë nuk ka asnjë veprimtari sipas grafikut të ekzekutimit të kontratës.

Në kontratë nuk është specifikuar formulari i raportimit nga Kontraktuesi, në mos zbatim të Nenit 6. Sipas Nenit 8, nuk është bërë plan pagesa për shërbimet. Referuar Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normat Teknike Profesionale (nenet 11-20 dhe 25-31) , Ligjit Nr.



7829 datë 01.06.1994“ Për Noterinë” neni 50 , dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë” miratuar me Urdhrin Nr. 5745, datë 13/08/2008, të ndryshuar me Urdhrin Nr. 371/1, datë 10/09/2013, të Ministrit të Drejtësisë në Nenin 22 pika 7 Hartimi i dokumenteve administrative të krijuara në Ministrinë e Drejtësisë, Akti administrativ, përpara se të dërgohet për firmë tek autoriteti administrativ duhet të ndjekë këtë procedurë: Në grupin e akteve administrative futen edhe programet e punës sipas strukturave përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, programe të bashkëpunimit me vendet e ndryshme dhe çdo dokument tjetër i cili kërkon angazhim të burimeve njerëzore, financiare. Këto akte miratohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Aktet administrative sipas rastit mund të kërkojnë nënshkrimin për çdo fletë.

Kontrata Prokurimit Shërbimi Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 rezulton se nuk është e firmosur faqe për faqe nga Nëpunësi Autorizues, ish Sekretaria e Përgjithshme znj. J.H por ka firmë (nënshkrim) dhe vulë të Ministrisë së Drejtësisë vetëm në fund të kontratës si dhe nuk ka numër faqesh të cituar (bashkëlidhja) por edhe nuk ka marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (SLA) të firmosur dhe të bashkëlidhur si aneks kontrate sipas Nenit 2 pika c të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Dokumenti i protokolluar dhe i shoqëruar me kartelë shoqëruese të praktikës në Ministrinë e Drejtësisë është vetëm Fatura Tatimore Shitje Nr.31,datë 21.03.2017 me numër serie 33183442 të Operatorit ekonomik “R.” vlefte me TVSH 221.952.000 lekë (*ndërkohë që nuk protokollohet fatura tatimore*), dokumentet e tjera si Formulari i Sigurimit të Kontratës Nr. Serie 0020161 datë 21.02.2017 i lidhur me Shoqërinë e Sigurimeve “E.” në vlerën 23.395.200 lekë dhe Relacioni Teknik, Ministria e Drejtësisë “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” nga BOE “R.” (pa datë) nuk rezultojnë të protokolluar.

Me Urdhrin Nr. 8383/12 Prot, datë 23.02.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës së Prokurimit Shërbimit Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 me Objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” ish Sekretaria e Përgjithshme Znj. J. H ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje si më poshtë :

-Z. E. A, Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse

-Z. G. A, Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

-Z. Sh. N, Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

2. Grupi i punës të ndjekë dhe zbatojë kontratën në përputhje me termat e referencës, specifikimet teknike dhe grafikun e shërbimeve që janë pjesë përbërëse e kontratës.

3. Grupi i punës të mbajë procesverbal pas çdo verifikimi të shërbimit të ofruar, objekt i kësaj kontrate.

Rezulton se Shtojca 9, Specifikimet Teknike në faqen 28 të Dokumenteve Standarde të Procedurës së Hapur Shërbime “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” **është tërësisht bosh e paplotësuar** kjo në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” në referim të Nenit 23 pika “a”, Specifikimet Teknike:

*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

BOE "R." ka lëshuar Faturën Tatimore Shitje Nr.31 datë 21.03.2017 me Nr. serial 33183442 në vlerën totale 221.952.000 lekë (me TVSH) për zërat dhe sasitë e mëposhtme dhe më pas deri në shkëputjen e kontratës nuk ka lëshuar asnjë fature për mirëmbajtjen :

Kjo Fature Tatimore është Protokolluar në Ministrinë e Drejtësisë me Nr. 1944 Prot, datë 21.03.2017 (Faturat Tatimore nuk protokollohen)

Nr. i Zërave	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Total me TVSH(lekë)	Afati
1	Përmirësim Sistemi SME	1	136.200.000	1 Muaj
2	Aplikacion Mobile Monitorimi	1	42.000.000	1 Muaj
3	Byzylyk Elektronikë	300	30.060.000	1 Muaj
4	Instalim Konfigurim Sistem Aks Kontroll	1	3.000.000	1 Muaj
5	Blerja dhe Instalim kamera Sigurie	10	1.176.000	1 Muaj
6	Instalim dhe Konf Sistem Monitorimi Kamera	1	2.220.000	1 Muaj
7	Instalim Konf Sistem Mbrojtje nga Zjarri	1	1.176.000	1 Muaj
8	Instalim dhe Konfigurim Sistem Menaxhimi	1	2.640.000	1 Muaj
9	Trajnim	1	3.480.000	1 Muaj

#### Grafiku i Ekzekutimit sipas Shtojcës 11

Nr.	Emërtimi Fazës/Periodha kohore	Java Parë	Java Dytë	Java Tretë	Java Katërt	Muaji 2- Muaji 49
1	Faza përgatitore për sistemin software	X				
2	Faza e përmirësimit të sistemit software		X			
3	Instalimi dhe konf Akses Kontroll		X			
4	Blerja dhe Instalimi i kamerave të sigurisë		X			
5	Instalimi dhe konfigurimi i		X			



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

	sistemit te monitorimit me kamera					
6	Instalimi dhe konfigurimi i sistemit për mbrojtje dhe sinjalizim nga zjarri		X			
7	Instalimi dhe konfigurimi I sistemit te menaxhimit			X		
8	Lëvrimi i byzylykëve elektronike			X		
9	Faza e Integritimit dhe testimit te sistemit software				X	
10	Trajnim i përdoruesve				X	
11	Marrja ne dorëzim				X	
12	Mirëmbajtja					X

Konstatohet se, tre proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të kryera të gjitha brënda një dite të vetme më datë 21.03.2017 duke mos respektuar grafikun javor të ekzekutimit të sipas kontratës sipas shtojcës 11 dhe për Byzylykët Elektronikë ne kundërshtim me dhe nenin 11 të Kontratës, por edhe të Ligjit 10 494 datë 22.12.2011 “Për mbikëqytjen elektronike të personave, te cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” në nenet 11,12,13,14.

Nga auditimi u konstatua, mungesë e një relacioni të plotë argumentues mbi mënyrën sesi janë vlerësuar pajisjet përpara se të merren në dorëzim, apo testimet që janë kryer nga ana e grupit të punës. Rezulton se **ka vetëm tre proces verbale për marrjen ne dorëzim (Byzylyk Elektronikë, Sistem Akses Kontroll, Sistem Kamera Sigurie nga nëntë zërat e faturës** së bashku me fletë hyrjet si dhe një dokument Trajnim për stafin në vleftën totale me TVSH **34.236.000 lekë**, ndërkohë që është kryer likuidimi pjesor në vlerën **150.000.000 lekë ose afro 63%** të faturës tatimore referuar Urdhër Shpenzimit nr.129 datë 18.04.2017 (jo i plotë). Dokumentacioni justifikues bashkangjitur janë 3 fletë hyrje nr.19, 19/1, 19/2 datë 21.03.2017 dhe një proces verbal shërbimi me datë 21.03.2017. Proces verbali i shërbimit nuk ka të referuar ndonjë vlerë financiare.

**Grupi auditimit nuk merr dot siguri të arsyeshme pasi nuk ka gjurmë auditimi për të konkluduar se cilës nga zërat e faturës i referohet kjo pagesë pjesore.**

Ky fakt vërtetohet katërcipërisht dhe nga Akt Dorëzimi i kryer nga BOE “R.” **vetëm për tre mallra**, 300 copë Byzylyk Elektronike (+ Sim Card) IMEI bashkangjitur, një Sistem Akses Kontroll, dhjetë Sistem Kamera Sigurie datë 21.03.2017.

Për më tepër në të tre proces verbalet është nënvizuar se grupi i punës kontrolloi mallin vetëm nga ana vizuale për sasinë, dëmtime të ndryshme ambalazhimit dhe se mallrat janë furnizuar ne zbatim të **kontratës së shërbimit Nr.8383/12 datë 23.02.2017** (ky dokument është urdhri për ngritjen e grupit të punës) duke ju referuar ne mënyrë krejt te gabuar kontratës së prokurimit shërbimit e cila mbart Nr.8383/10 Port, datë 21.02.2017.



Në lidhje me **Proces Verbalin datë 21.03.2017 për “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale Mars 2017”** në të cilin ka firmosur grupi i punës dhe BOE “R.” përsëritet se Kontraktori ka plotësuar kërkesat për të gjitha zërat e faturës.

Ky dokument kundërshtohet për vërtetësinë e tij nga Grupi Auditimit sepse Aplikacioni Mobile është instaluar me datë 06.09.2017. (Në zbatim të Urdhrit Nr.4716/2 datë 31.07.2017 janë mbajtur 8 procesverbale nga data 31.07.2017 deri më 18.08.2017 të shtjelluara më poshtë) bazuar në korrespondencën midis Drejtorit DME z. A. B dhe znj. M. M të BOE “S. S”.

Sa më sipër grupi i auditimit nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi këtë dokument, për sa kohë që nuk plotëson kushtet e një dokumenti zyrtar, në mungesë të plotë të ekstremiteteve.

Po ashtu, mungon gjurma e një relacioni argumentues të situatës për periudhën e vlerësimit.

Nuk ka Akt Kolaudimi për të gjitha mallrat dhe shërbimet të përfshira në kontratë në kundërshtim me VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në Nenin Neni 77 pika 6 Mbikëqyrja e kontratës.

Për sa më sipër, rezulton se **nuk është kryer brenda 1 muaji periudha e zbatimit të kontratës** se lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe BOE, në kundërshtim me Dokumentet Standard të Tenderit Shtojca 12.Termet e Referencës pika 5.2 (të ndryshuar sipas shtojcës për një saktësim në DT datë 11.01.2017, Data e Fillimit dhe Periudha e implementimit të Detyrave:

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe **periudha e zbatimit të kontratës do të jete 1 muaj nisur nga kjo datë.**

Me Fletë Dalje Nr.39 datë 21.03.2017 është kryer dalja e 300 copë Byzylyk Elektronikë nga magazina e Ministrisë së Drejtësisë tek Salla e Mbikëqyrjes Elektronike dhe më datë 11.04.2017 me Nr.834 Prot është kryer dorëzimi i pajisjeve gjurmuese nga z. G. A, Z. Sh. N dhe z. E.D, tek BOE “R.”.

Me shkresën Nr.1740 datë 11.08.2017 Shërbimi i Provës ka njoftuar të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore se ka 0 (zero) pajisje në dispozicion për realizuar procesin e mbikëqyrjes elektronike.

Me shkresën Nr. 4716/15 Prot, datë 10.08.2017 dhe Nr. 4716/16 Prot, datë 11.08.2017 ish Ministri Teknik z. G. B ka kërkuar nga ish Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit z. H. C dhe ish Prokurori i Përgjithshëm z. A. Ll ***ndërhyrjen urgjente për të verifikuar dhe mbikëqyrur në banesë personat që ndodhen aktualisht në mbikëqyrje elektronike dhe ndërhyrjen për të komunikuar prokurorëve të rretheve situatën aktuale në të cilën gjendet Sistemi i Mbikëqyrjes Elektronike pasi ndodhemi para faktit që nuk mundet të japim garanci mbi funksionimin e këtij sistemi.***

Me Urdhrit Nr.4716/2 datë 31.07.2017 ish Ministri Teknik z. G. B ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar sipas kontratës me Nr.8383/10, datë 21.02.2017 me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”.

Në zbatim të Urdhrit Nr.4716/2 datë 31.07.2017 janë mbajtur 8 procesverbale nga data 31.07.2017 deri më 18.08.2017.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.1 i datës 31.07.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Anëtarët e grupit të punës u njohën dhe diskutuan mbi përmbajtjen e Urdhrit të punës Nr.4716/2, datë 31.07.2017 të Ministrit të Drejtësisë, i cili ka të bëjë me marrjen në dorëzim apo posedim të mallrave të blere nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Nëpërmjet kontratës Nr. 8383/10, datë 21.02.2017. Sasia prej 300 cope e byzylykëve me Flete-Dalje Nr.39 siç është marrë në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë i ka kaluar përmes një akti dorëzimi në administrim Sallës së Mbikëqyrjes Elektronike, pa kryer procedurat ligjore të transferimit kapital të tyre nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës. **Me Akt Dorëzimin me Nr. Prot. 834, date 11.04.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës më date 11.04.2017 e ka dorëzuar sasinë prej 300 cope Byzylykë Elektronike (+Sim Card përfshirë) nga Salla e Mbikëqyrjes Elektronike tek Bashkimi i Operatoreve.**

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.2 i datës 31.07.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

të cilët në përmbajtjen e procesverbalit kanë deklaruar **që në përdorim të sistemit SME ishin vetëm 78 pajisje gjurmuese byzylyk, ndërkohë që operatori duhet të dorëzonte pjesën prej 300 byzylyk. Procesverbali nr.2 bie ndesh me procesverbalin e marrjes në dorëzim nga ana e grupit të punës që mban datën 21.03.2017 ku citohet që janë marrë në dorëzim të gjitha byzylykët, po ashtu dhe nga ana e magazinieres.**

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.3 i datës 03.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse ne mungese

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

Në orën 13:00 datë 03.08.2017 u paraqit një person i prezantuar me emrin G. C. (si përfaqësues i F. sh.p.k) për dorëzimin e mallrave pranë Ministrisë së Drejtësisë njëkohësisht dorazi ne Sektorin e Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë është dorëzuar nga kompania **shkresa me Nr. 32 Prot. 4716/6 datë 03.08.2017 me anë të së cilës shprehej se u kërkua dorëzimi i 218 cope Byzylykë Elektronike (+Sim Card).**

Nga verifikimi rezulton se kompania nuk kishte përmbushur porosite dhe kërkesat e grupit të punës, dhe malli nuk ishte i shoqëruar me raportin dhe dokumentacionin e plote si dhe nuk ishte paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë i shoqëruar nga personi që ka tagrat e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatoreve Ekonomike apo nga një person tjetër i pajisur me autorizim të posaçëm nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.4 i datës 09.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse ne mungese





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

Në orën 09:00 në ambientet e Sallës së Mbikëqyrjes Elektronike u paraqit z. M. K përfaqësues ligjor i bashkimit të operatoreve ekonomikë “S.S” sh.p.k, “F.” sh.p.k., dhe “R.” sh.p.k shoqëruar me ekipin e tij teknik. Konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë , nga Bashkimi i operatoreve ekonomike, “S.S” sh.p.k, “F.” sh.p.k., dhe “R.” sh.p.k, u paraqiten për verifikim sasior dhe cilësor artikulli Byzylyk(+SIM Card përfshirë) sipas gjendjes së përshkruar si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Shënime
1	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	82	Aktualisht në sistemin SME
2	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	77	Te përdorura(te reja në kuti)
3	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	62	Te përdorura, janë hequr nga subjekti
4	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	3	Material verifikimi nga policia dhe dërguar në laborator për ekzaminim.
5	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	1	Defekt fabrike. Proceduar në garanci.
6	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshirë)	Cope	75	Te dëmtuara. Paketuar për dërgim në laborator për ekzaminim.
	Shuma	Cope	300	Shifrat sipas sasisë së blere.

Më tej grupi i punës në vazhdim të procedurës së marrjes në posedim të artikullit byzylyk elektronik, konkludoi se ishte e nevojshme që procesi të ndahet në dy faza si më poshtë:

- 1) Faza e verifikimit fizik të treguesve sasior të byzylykëve elektronik, bazuar në sasinë e parashikuar në Kontratën Nr.8383/10 Prot., datë 21.02.2017.
- 2) Faza e verifikimit të treguesve cilësor, të byzylykëve elektronik, sipas metodës së kampionimit rastësor të 10% të pajisjeve gjurmuese(byzylyk elektronik), që administrohen nga operatori dhe që janë në gjendje pune.

Në përfundim të procesit të verifikimit fizik të treguesve cilësor, sipas ndarjes më sipër rezultoi se plotësohet sasia prej 300 cope byzylykë elektronike, sipas termave të Kontratës Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017. Sasia e mundur për tu marrë në posedim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në këtë moment është vetëm Artikulli Nr.2 dhe Artikulli Nr.3.

Konkretisht sasia prej 77 pajisje gjurmuese të përdorura dhe sasia prej 62 pajisje gjurmuese të përdorura por në gjendje pune. Pra gjithsej 139 pajisje gjurmuese mund të merren në posedim në këtë moment nga Ministria e Drejtësisë Kjo sasi prej 139 pajisje gjurmuese që do të merret në dorëzim, do të nënshtrohet fazës së dytë të verifikimit, që përfshin vlerësimin e treguesve sasior sipas metodës së kampionimit rastësor të 10% të kësaj sasive.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.5 i datës 10.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrorit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse në mungesë

Z. E. A Drejtor i TI



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

Në orën 09:00 siç ishte rënë dakord me përfaqësuesit e kompanisë duhet të vijonte procesi për verifikim dhe vlerësimin e treguesve funksionale (cilësore) të pajisjeve Byzylyk Elektronik + Sim Card për 8 pajisjet e konfiguruar në datë 09.08.2017 si dhe të vijojë procesin e konfigurimit për 7 pajisje të tjera që do të përzgjidhen në mënyrë rastësore. Në orarin e rënë dakort nuk u paraqit asnjë përfaqësues i kompanisë. Në orën 09:30 pas një komunikim me përfaqësuesin e kompanisë i cili konfirmojë se do të paraqiteshin më vonë për shkak të mungesës së stafit në dispozicion.

**Por sipas DST operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion të ofrimit të këtij shërbimi:**

- 1) Të paktën 10 eksperte teknikë të kualifikuar për implementimin, evidentimin dhe mbështetjen e projektit.
- 2) Të ketë të punësuar për ofrimin e shërbimit në objekt të paktën 5 inxhinierë elektronik dhe 5 inxhinierë informatikë.
- 3) Të ketë në dispozicion të paktën 3 punonjës me detyrë montues i pajisjes.

*Ne këtë kuadër , justifikimi për mungese stafi është i pambështetur në detyrimet që ka marre përsipër sipas DST.*

Në orën 11:00 më datë 10.08.2017 në Ministrinë e Drejtësisë u paraqit specialisti i suportit teknik z. S. M së bashku me përfaqësuesin e bashkimit të operatorëve Z. M. K për të tërhequr 3 pajisje gjurmimi të reja në kuti byzylyk elektronik dhe sim card me qëllim realizimin e shërbimit të kërkuar nga zyra Vendore e Shërbimit të Provës Shkodër dhe Salla e Mbikëqyrjes Elektronike. Artikulli Nr.2 i akt dorëzimit datë 09.08.2017 të Bashkimit të Operatoreve nga 77 copë u pakësua me 3 copë, mbeti vlerë në ruajtje e këtij artikulli në sasinë 74 cope.

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Shënime
2	Byzylykë elektronik(+SIM Card përfshire)	Cope	74	Te përdorura(te reja ne kuti)

Në orën 15:04 Grupi i Punës filloi testimin e pajisjes gjurmuese me Nr. IMEI 861508037022043 e cila ishte e konfiguruar dhe ishte e lënë gati për testim nga përfaqësuesit e BOE "R." që prej datës 09.08.2017. Ne momentin e testimit gjendja e baterisë rezultonte 100%.

Gjate procesit të testimit kishte probleme me:

- 1) Funksinin e shkëputjes së rripit dhe mos dhënie të alarmit në sistem.
- 2) Dalje nga zona e lejuar dhe mos dhënie në sistem.
- 3) Vonese në sistem të Butonit SOS.
- 4) Vendosje dhe heqjen e pajisjes nga karikimi sistemi sinjalizoi në kohe.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.6 i datës 11.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse në mungese

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Ne orën 12:00 Grupi i Punës vendosi të vijojë vetë procesin e testimit , duke i kërkuar Ministrin të Drejtësisë që të kërkonte ndihmë dhe bashkëpunimin e dy ekspertëve të AKSHI-t.

Në orën 12:20 grupi i punës konstatojë se kompania kishte hequr nga sistemi elektronik të gjitha pajisjet gjurmuese që ishin konfiguruar në datën 09.08.2017 gjë që pamundësonte realizimin e këtij procesi.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.7 i datës 11-14.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrin Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse ne mungese

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

Në orën 14:30 në Sallën e Mbikëqyrjes Elektronike u paraqiten përfaqësuesit e operatorit ekonomik si me poshtë:

- 1) Z. M. K, përfaqësuesi ligjor i bashkimit te operatoreve ekonomik
- 2) Z. G. H , ekspert teknik
- 3) Z. S. M, ekspert teknik
- 4) Z. E. Sh, ekspert teknik

Përfaqësuesit e kompanisë do të qëndrojnë në salle vetëm për konfigurimin e pajisjeve (që nënkupton si konfigurimin dhe regjistrimin e tyre në sistemin e mbikëqyrjes elektronike) dhe nuk do të qëndrojnë gjate testimit të funksionalitetit të tyre.

Prezent ne salle ku do te realizohet testimi janë edhe:

- 1) Z. G. B, Ministër i Drejtësisë
- 2) Znj. K. T, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit (ne mungese-Sekretar i Përgjithshëm)
- 3) Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës Z. I. Q
- 4) 2 përfaqësues të AKSHI-t Z. E.Y dhe Z. M. C
- 5) 3 përfaqësues te Ministrisë se Drejtësisë që janë duke audituar dosjen e kontratës se lidhur për Sistemin e Mbikëqyrjes Elektronike:
  - 1) Znj. R. H
  - 2) Z. A. B
  - 3) Z. L. A
- 6) Punonjësit e Sallës së ME që janë ne turn, Z. L. D dhe Z. E. H.

Grupi i Punës ka vendosur që në sasinë prej 74 Byzylykëve të papërdorur ta marre si vlerë në ruajtje në datën 09.08.2017 si dhe 62 Byzylykë të marrë si vlerë në ruajtje por te përdorur më parë të kryejë testimin në 10% të tyre. Grupi i punës në mënyrë rastësorë përzgjedh 8 pajisje.

Pajisjet gjurmuese të përzgjedhura kanë këtë Nr.IMEI:

- 1) 8615080392642013
- 2) 861508039265020
- 3) 861508039253604
- 4) 861508039252945
- 5) 861508037032166
- 6) 861508039265861
- 7) 861508039264411
- 8) 861508037027166



Në orën 20:00 grupi i punës vijoj me përzgjedhjen e 7 pajisjeve të tjera gjurmuese, për te vijuar procesin e testimit. Pajisjet me Nr. IMEI si me poshtë:

- 1) 861508039253869
- 2) 861508037027620
- 3) 861508037022951
- 4) 861508039263918
- 5) 861508037041662
- 6) 861508037031721
- 7) 861508039268149

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të treguesve cilësor të pajisjeve, sipas metodës së kampionimit rastësor të 10% të pajisjeve në gjendje pune, pra 15 pajisje gjurmuese të cilat rezultojnë funksionale.

- ✓ Grupit të auditimit i vihet në dispozicion **Procesverbali Nr.8 i datës 18.08.2017**, i firmosur nga anëtarët e grupit të punës sipas urdhrit Nr. 4716/2 datë 31.07.2017, si më poshtë:

Z. A. L Drejtor i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse ne mungese

Z. E. A Drejtor i TI

Z. N. H Specialist

Znj. V. A Magaziniere

Z. G. A Drejtor i sallës së mbikëqyrjes elektronike

Në mbledhje mori pjesë dhe z. M. K, përfaqësues ligjor i bashkimit të operatorëve ekonomik. Në mbledhje u vendos të konsiderohej e përfunduar procesi i rimarrjes në posedim i pajisjeve të gjurmimit Byzylyk Elektronik në gjendje pune.

Merren në posedim pajisjet gjurmuese të papërdorura 70 copë.

Merren në posedim pajisjet gjurmuese të papërdorura por në gjendje pune 64 copë.

Të mos marrë në posedim 4 pajisje gjurmuese, janë në proces ekzaminimi apo kanë rezultuar me defekt fabrike.

Të mos marrë në posedim sasinë prej 81 copë byzylyk elektronik të cilat rezultojnë të dëmtuara gjatë përdorimit nga subjektet nën mbikëqyrjen elektronike.

Sasia prej 81 byzylykëve që janë aktualisht në gjendje pune dhe të vendosura tek subjektet nën mbikëqyrjen elektronike të konsiderohet e pa marrë në posedim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë e cila do të kryejë procesin e verifikimit të treguesve sasiore dhe cilësore.

Grupi i Punës kërkoi nga operatori ekonomik që të bëjë instalimin e Aplikacionit Mobile të ME, ky proces të përfundojë brenda 20 ditëve nga nënshkrimi i këtij procesverbali.

*Nga ky moment e më pas, megjithëse Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Provës ka pasur pajisje në dispozicion nuk ka kryer asnjë njoftim të dytë drejtuar Prokurorive dhe Gjykatave për të vendosur në mbikëqyrje elektronike individë të tjerë në Sistemin e Mbikëqyrjes Elektronike, si edhe nuk ka vendosur asnjë person në mbikëqyrje elektronike.*

Në lidhje me kontratën e mësipërme të përmirësimit të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, është kryer inspektimi financiar, bazuar në vendimin e nëpunësit të parë autorizues me Nr. 125, datë 25.10.2018. Në përfundim të Inspektimit Financiar ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë në Dhjetor 2018 për pesë procedura tenderi, Ministri i Financave z. A.A ka nxjerrë **Urdhrit Nr. 329 datë 05.12.2018** me Nr.18415/25 Prot “Për përfundimin e Inspektimit Financiar Publik” ka urdhëruar Ministrinë e Drejtësisë **për masën shpërblim dëmi në shumën prej**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

**150,000 mijë lekë** për Kontratën e Prokurimi Shërbimi Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” të vlerësuar si Dëm Ekonomik në buxhetin e shtetit për mosfunksionim të plotë të sistemit të mbikëqyrjes elektronike ndaj personave penale, përfituar nga kontraktoret zbatues JV “F.” & “R.” & “S. S” sh.p.k.

Në vijim të këtij Urdhri, Ministria e Drejtësisë ka nxjerre **Urdhrin Nr.48 datë 12.02.2019** "Për miratimin e zbatimit të planit të masave" për **Faturën për Arkëtim Nr.2 date 12.02.2019** i cili detyron Bashkimin e Operatorëve të kthejë shumën prej **150.000.000** lekë për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

**Nga dalja e Urdhrit të MD dhe MF për arkëtimin e faturës Nr.2 datë 12.02.2019, nuk është marrë asnjë masë** nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për arkëtimin e shumës dhe më **datë 02.05.2019** është regjistruar procedimi administrativ me paditës BOE “R.”, palë e kundër paditur në vijim të procedurës me objekt i padie “Përmbushja e detyrimit të lindur nga kontrata e prokurimit Nr.8383/10Prot. datë 21.02.2017 me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”, në vlerën 71.952.000lekë” Pagimi i kamatave ligjore në vlerën 2.101.736 lekë të përlllogaritur nga data 13.12.2018 deri në depozitimin e kërkesë Padisë; Pagimin e kamatave ligjore të përlllogaritur nga data e depozitimit të kërkesë padisë deri në ekzekutimin e detyrimit, sipas kamatës ligjore ditore prej 1455.57 lekë në ditë”

**Në datë 19.09.2019, me shkresën Nr.6473 Prot, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, z. G.D, ka njoftuar BOE “R.” për ndërprerjen e Kontratës së Mbikëqyrjes Elektronike me Nr.8383/10 datë 21.02.2017, duke referuar Nenin 25 të kësaj kontrate i cili sanksionon ndërprerjen e kontratës në shërbimin më të mirë të interesit publik.** Në seancën për veprime përgatitore të datës 10.10.2019, pala e paditur Ministria e Drejtësisë paraqiti kundërpadinë 4065/8 datë 24.09.2019 e cila u pranua nga gjykata duke bashkuar gjykimet.

**Grupi i Auditimit gjatë këqyrjes së ambienteve fizike rezultoi se Sistemi i Mbikëqyrjes Elektronike SME rezultoi i fikur dhe jo në përdorim që prej periudhës kur është kryer shkëputja e kontratës. Nga intervistimi i drejtorit aktual të mbikëqyrjes elektronike, sistemi nuk ka funksionuar nga viti 2019.** Grupi i auditimit i kërkoi vënien në dispozicion të deklaratave, shkresave që të çojnë drejt arsyes të mosfunksionimit të sistemit. Në këto kushte Ministria e Drejtësisë gjendet në moszbatim të Ligjit 10 494 datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” si edhe në referim të Nenit 1, të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar.

**Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur komente me shkresën Nr.769/8 Prot, datë 08.05.2024 nga z. I. Sh, protokolluar në KLSH me Nr.1067/11 datë 09.05.2024, si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit:**

*- Procedura e prokurimit objekt auditimi nga KLSH është realizuar në vitin 2017, për rrjedhojë kjo procedure duhet të vlerësohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në kohën e realizimit të saj, përkatësisht Ligji 9643, date 20.11.200 “Për Prokurimin Publik”- i ndryshuar, VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”- i ndryshuar...Ministria e Drejtësisë shpreh dakordësi paraprake mbi rekomandimet e lëna.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**



*Pavarësisht nga dakordësia e shprehur nga subjekti i audituar, grupi i auditimit ka arritur në përfundim të auditimit në rekomandimet përkatëse.*

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

###### **1. Konstatimi:**

**1.1.** Nga auditimi rezulton se Kontrata e Prokurimit të Shërbimit Nr.8383/10 Prot, datë 21.02.2017 ka parregullsi e mangësi në hartimin dhe plotësimin e saj, pasi disa nene janë lënë bosh të paplotësuara; ka shtim pikash në Nenet e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës dhe në Kushtet e Veçanta të Kontratës krahasuar me Shtojcën 16 të Dokumenteve Standarde të Tenderit në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, Neni 60/1 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, që përcakton se “Kushtet e kontratës, të lidhura sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese” dhe të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 22 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, në faqet 11-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.2.** Nuk ka gjetur zbatim Neni 6, pika 2 e KPK së Kontratës, që lidhet me pronësinë intelektuale dhe dorëzimin në fund të kontratës nga BOE tek AK të Kodit në Burim, raporteve dhe hartave, diagrameve, skicimeve dhe çdo materiali tjetër të mbledhur ose përgatitura nga kontraktuesi gjatë implementimit të kontratës. Pas kërkesave të përsëritura në mënyrë zyrtare pranë subjektit të audituar, grupit të audituesve të autorizuar të KLSH-së nuk i janë vënë në dispozicion sipas Shtojcës 12 “Termet e Referencës: Kodi në Burim, Testimi i Sistemit të Përmirësuar (rezultat i cili duhet të arrihet nga BOE), sipas pikës 2.3, Tre raportet, Sipas pikës 4.2 Detyrat Specifike 9. Testimi i Sistemit SME, 11. Go Live i Sistemit SME, 12. Mirëmbajtja e sistemit SME (për të cilën BOE “R.” nuk ka lëshuar faturë tatimore në asnjë moment, Raporti Fillestar, Draft Raporti, Raporti Final sipas pikës 6 Raportimi. Sipas Nenit 8, Kontraktuesi duhet të kryejë gjitha shërbimet siç specifikohet tek Termet e Referencës, gjë që nuk ka ndodhur pasi në pikën 2.3 parashikohet Testimi i SME dhe Mirëmbajtja për një afat 4 vjeçar që nga momenti i implementimit të sistemit, shërbime të cilat nuk janë kryer pasi në asnjë moment përgjatë viteve nuk është lëshuar asnjë faturë nga BOE “R.”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, në faqet 11-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.3.** Kontrata e nënshkruar për Prokurimin e Shërbimit me Nr. 8383/10 Prot, datë 21.02.2017 rezulton se nuk është e firmosur rregullisht në çdo faqe nga Nëpunësi Autorizues, ish Sekretari i Përgjithshëm si dhe nuk ka numër faqesh të cituar (bashkëlidhja) si dhe nuk ka marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (SLA) të firmosur dhe të bashkëlidhur si aneks kontrate sipas Nenit 2 pika c të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. Dokumenti i protokolluar dhe i shoqëruar me kartelesh shoqëruese të praktikës në Ministrinë e Drejtësisë është vetëm Fatura Tatimore Shitje Nr.31, datë 21.03.2017, ndërkohë që dokumentet e tjera si Formulari i Sigurimit të Kontratës Nr. Serie 0020161 datë 21.02.2017 dhe Relacioni Teknik, Ministria e Drejtësisë “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” nga BOE “R.” (pa datë) nuk rezultojnë të protokolluar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, në faqen 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.4.** Konstatohet se, tre proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të përpiluar të gjithë brenda një ditë të vetme (datë 21.03.2017), duke mos respektuar grafikun javor të ekzekutimit sipas kontratës,



shtojcës 11, në kundërshtim me nenin 11 të Kontratës, Ligjit 10 494 datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” nenet 11,12,13,14. U konstatua se mungon një relacion i plotë argumentues mbi mënyrën sesi janë vlerësuar pajisjet përpara se të merren në dorëzim, apo testimet që janë kryer nga ana e grupit të punës. Ka vetëm tre proces verbale për marrjen në dorëzim (Byzylyk Elektronikë, Sistem Aksess Kontroll, Sistem Kamera Sigurie) nga nëntë zërat e faturës së bashku me fletë hyrjet si dhe një dokument Trajnimi për stafin në vleftën totale 34.236.000 lekë me TVSH ndërkohë që është kryer likuidimi pjesor në vlerën 150.000.000 lekë ose afro 63% të faturës tatimore referuar Urdhër Shpenzimit Nr.129 datë 18.04.2017 (jo i plotë), ku dokumentacioni bashkangjitur janë 3 fletë hyrje Nr.19, 19/1, 19/2 datë 21.03.2017 dhe një proces verbal shërbimi i datës 21.03.2017 i cili nuk ka të specifikuar ndonjë vlerë financiare.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, në faqet 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.5.** Mungon Akti i Kolaudimi për të gjitha mallrat dhe shërbimet e përfshira në kontratë dhe të furnizuara nga BOE, në kundërshtim me VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Neni 77, pika 6 “Mbikëqyrja e kontratës”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1a dhe 2.1b, në faqen 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.6.** Në lidhje me kontratën e përmirësimit të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, është kryer inspektimi financiar, bazuar në vendimin e nëpunësit të parë autorizues me Nr. 125, datë 25.10.2018. Në përfundim të Inspektimit Financiar ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë në Dhjetor 2018 për pesë procedura tenderi, Ministri i Financave ka nxjerrë Urdhër Nr. 329 datë 05.12.2018 “Për përfundimin e Inspektimit Financiar Publik” duke urdhëruar Ministrinë e Drejtësisë për masën shpërbim dëmi në shumën prej 150,000 mijë lekë, për Kontratën e Prokurimit Shërbimi me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale” të vlerësuar si Dëm Ekonomik në buxhetin e shtetit për mosfunksionim të plotë të sistemit të mbikëqyrjes elektronike ndaj personave penale, përfituar nga kontraktoret zbatues JV “F.” & “R.” & “S. S” sh.p.k. Në vijim të këtij Urdhri, Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë Urdhër Nr.48 datë 12.02.2019 “Për miratimin e zbatimit të planit të masave” për Faturën për Arkëtim Nr.2 datë 12.02.2019, i cili detyron Bashkimin e Operatorëve të kthejë shumën prej 150.000.000 lekë për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale. Nga dalja e Urdhrit të MD dhe MF për arkëtimin e faturës Nr.2 datë 12.02.2019, nuk është marrë asnjë masë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për arkëtimin e kësaj shume.

Konstatohet se, më datë 02.05.2019 është regjistruar procedimi administrativ me paditës BOE “R.”, palë e kundër paditur në vijim të procedurës me objekt i padie “Përmbushja e detyrimit të lindur nga kontrata e prokurimit Nr.8383/10Prot. datë 21.02.2017 me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”, në vlerën 71.952.000 lekë”, Pagimi i kamatave ligjore në vlerën 2.101.736 lekë të përllëguar nga data 13.12.2018 deri në depozitimin e kërkesë Padisë; Pagimin e kamatave ligjore të përllëguar nga data e depozitimit të kërkesë padisë deri në ekzekutimin e detyrimit, sipas kamatës ligjore ditore prej 1455.57 lekë në ditë”

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, në faqen 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

## **1.1. REKOMANDIME:**

**1.1.1.** Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) të marrin masa dhe analizojnë me përgjegjësi të gjithë parregullsitë e rezultuara gjatë procesit të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të mbikëqyrjes elektronike të personave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



**1.1.2.** Ministria e Drejtësisë të ngrejë një grup pune dhe marrë masat dhe verifikimin e ekzistencës dhe saktësimin vlerës së aktiveve afatgjata materiale dhe atyre qarkulluese, të kontabilizuara dhe paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.1.3.** Ministria e Drejtësisë në procedurat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në prokurimin publik. Në përbërje të grupeve të punës për procesin e mbikëqyrjes elektronike të angazhohen specialistë të IT-së për të mundësuar zgjidhjen e problemeve në kohë reale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.1.4.** Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrin masa të menjëhershme të përcaktimit të mjeteve dhe mekanizmave që mundësojnë bërjen efektive, funksionimin dhe sjelljen në efikasitet të plotë të sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale, ku shërbimi të ofrojë garancinë e sigurisë publike dhe ekzekutimin efektiv të vendimmarrjeve gjyqësore, në zbatim të Ligjit 10 494 datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” dhe të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## V. ANEKSE

### *Raportet mujore të Mbikëqyrjes Elektronike për vitin 2017*

	Vendosur ne mbikëqyrje Elektronike	Sistemi SME	Dale nga mbikëqyrja elektronike	Nr. Total ne mbikëqyrje	Nr. Pajisjeve ne dispozicion
Prill	20	i ngadalte ne operim + subjekte pa sinjale	17	91	209
Maj	13	I ngadalte ne operim + subjekte pa sinjale	24	80	220
Qershor	15	2 subjekte dale nga zona + nuk ka alarm	9	84	216
Korrik	15	1 subjekte dale nga zona + nuk ka alarm	21	79	221



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë**

Gusht	6				
Shtator	0		15	66	147
Tetor	0	44 subjekte pa sinjale +21 raste për suport teknik	10	56	157
Nëntor	0	28 raste vëndodhjen gabuar + 26 raste suportit teknik + 20 raste pa sinjale+ 17 raste pa energji	9	47	166
Dhjetor	0	20 raste suportit teknik (7 vëndodhjen gabuar + 13 probleme me hartën) + 28 raste pa energji	5	42	171

***Raportet mujore te Mbikëqyrjes Elektronike për vitin 2018***

	Vendosur në mbikëqyrje elektronike	Suport Teknik	Vëndodhje e gabuar	Probleme me hartën	Ndërpreja e energjisë	Dale nga zona e lejuar	Kushtet e emergjencës	Dale nga mbikëqyrja elektronike	Asistence kompanisë
Janar	0 subjekte	31 raste	4 raste	27 raste	9 raste	5 raste	3 raste	3 subjekte	18 raste
Shkurt	0 subjekte	11 raste	5 raste	6 raste	29 raste	5 raste	2 raste	5 subjekte	23 raste
Mars	0 subjekte	6 raste	2 raste	7 raste	10 raste	2 raste	1 raste	3 subjekte	13 raste
Prill	0 subjekte	4 raste	2 raste	7 raste	9 raste	4 raste	0 raste	2 subjekte	10 raste
Maj	0 subjekte	4 raste	3 raste	5 raste	5 raste	3 raste	0 raste	2 subjekte	7 raste
Qershor	0 subjekte	-	-	-	4 raste	3 raste	0 raste	3 subjekte	2 raste
Korrik	0 subjekte	-	-	-	2 raste	3 raste	0 raste	2 subjekte	2 raste
Gusht	0 subjekte	-	-	-	1 raste	9 raste	1 raste	1 subjekte	14 raste
Shtator	0 subjekte	-	-	-	0 raste	9 raste	0 raste	0 subjekte	4 raste
Tetor	0 subjekte	-	-	-	3 raste	13 raste	2 raste	4 subjekte	14 raste
Nëntor	0 subjekte	-	-	-	1 rast	3 raste	4 raste	4 subjekte	4 raste
Dhjetor	0 subjekte	-	-	-	7 raste	3 raste	2 raste	1 subjekte	3 raste



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

#### *Përmbledhje e dinamikës së Mbikëqyrjes Elektronike për të gjithë subjektet në gjurmim për vitin 2018.*

Muaji	Alarme dalje nga zona e lejuar	Alarme, heqje dhe lidhje byzylyku	E-mail drejtuar suportit teknik	E-mail dhe telefonatat e kryera ne polici	Alarme, "ska sinjal", "ska bateri"	Subjekte qe nuk kane sinjale	Telefonata me subjektit dhe butoni SOS
Tetor	387	4454	45	39	134	2	151
Nëntor	612	3906	63	38	132	2	440
Dhjetor	389	8116	44	24	111	1	263

#### *Përmbledhje e dinamikës së Mbikëqyrjes Elektronike për të gjithë subjektet në gjurmim për vitin 2019*

	Alarme 'Dalje nga zona e lejuar'	Alarme 'Heqje dhe lidhje byzylyku'	Alarme 'Ska sinjal'	Alarme 'Butoni SOS'	Telefonata me subjektet	Email drejtuar suportit teknik	Telefonata me policinë	Email Sallave Operative	Subjekte qe nuk kane sinjal
Janar	25700,0	15559	112	103	103	37	22	56	1
Shkurt	313	7065	91	155	98	28	12	45	32
Mars	269	9105	60	140	104	27	9	41	40
Prill	121	3204	31	39	28	14	0	17	10
Maj	252	9421	76	64	93	21	5	33	4
Qershor	106	1417	21	28	26	11	4	14	7
Korrik	62	11	9	33	15	7	2	10	0
Gusht	90	229	38	19	11	1	1	21	0
Shtator	36	1735	9	4	3	0	0	3	0

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT